

ALBANIAN DIGITAL PRINTING SOLUTIONS & SERVICES Sh.p.k
Raporti i Audituesit të pavarur dhe
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 - 22

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakët e Shoqërisë Albanian Digital Printing Solutions & Services sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Albanian Digital Printing Solutions & Services shpk** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2018, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2018, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticismin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

8 mars 2019



Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2018

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	12,942,427	7,260,479
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	17,258,048	24,164,932
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	89,893	167,952
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	4,018,757	324,142
Inventari	8	10,944,318	10,711,386
Shpenzime të shtyra	9	10,469,679	4,281,684
Total aktive afatshkurtra		55,723,122	46,910,575
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	17,109,557	17,859,870
Aktive afatgjata jomateriale	11	22,142	35,093
Total aktive afatgjata		17,131,699	17,894,963
Total aktive		72,854,821	64,805,538
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	12	23,435	1,710,689
Llogari të pagueshme tregtare	13	3,714,066	9,340,605
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	14	18,966,423	8,138,509
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	15	11,750	10,823
Detyrime tatimore	16	661,723	1,116,183
Të ardhurat e shtyra	17	5,086,215	-
Të tjera detyrime	18	19,001	16,363
Total detyrime afatshkurtra		28,482,613	20,333,172
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	19	-	25,244
Total detyrime afatgjata		-	25,244
Totali i detyrimeve		28,482,613	20,358,416
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar		100	100
Rezerva ligjore		10	10
Rezerva të tjera		34,153,675	26,944,997
Fitimi i ushtrimit		10,218,423	17,502,015
Total kapitali	20	44,372,208	44,447,122
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		72,854,821	64,805,538

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	21	73,045,818	99,426,419
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		532,191	(10,265)
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	22	216,743	512,642
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(43,167,016)	(58,714,014)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	23	(37,335,580)	(52,499,846)
2) Të tjera shpenzime	24	(5,831,436)	(6,214,168)
Shpenzime të personelit	25	(14,621,280)	(15,600,335)
1) Paga dhe shpërblime		(13,019,161)	(13,854,761)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(1,602,119)	(1,745,574)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10/11	(3,420,011)	(4,216,653)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	26	(2,012)	(488)
Shpenzime financiare	27	(481,731)	(625,716)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(94,277)	(326,634)
2) Shpenzime të tjera financiare		(387,454)	(299,082)
Fitimi/humbja para tatimit		12,102,702	20,771,590
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	28	(1,884,279)	(3,269,575)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(1,884,279)	(3,269,575)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		10,218,423	17,502,015
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		10,218,423	17,502,015

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	100	10	23,773,986	16,651,661	40,425,757
Fitimi / Humbja e vitit				17,502,015	17,502,015
Lëvizjet përmes kapitalit			16,651,661	(16,651,661)	-
Dividendë të paguar			(13,480,650)		(13,480,650)
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2017	100	10	26,944,997	17,502,015	44,447,122
Fitimi / Humbja e vitit				10,218,423	10,218,423
Lëvizjet përmes kapitalit			17,502,015	(17,502,015)	-
Dividendë të paguar			(10,293,337)		(10,293,337)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	100	10	34,153,675	10,218,423	44,372,208

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë më 28 shkurt 2019:

Elvis Sula 

Elvis Sula
Administrator

Mazars Shpk

Mazars shpk
Hartues i Pasqyrave



Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@mazars.al



Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk
NIPT L11518003F - Tirana (00)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

Shënime	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	10,218,423	17,502,015
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Diferenca këmbimi jo nga aktivitete operative	342,201	12,948
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	-	483,204
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	3,420,011	4,216,653
Vlera kontabël e aseteve te dala jashtë përdorimit	43,022	-
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(2,897,667)	2,655,088
Rënie/(rritje) në inventarë	(232,932)	(2,411,687)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	9,834,054	(1,035,072)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	2,641	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	20,729,753	21,423,149
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(2,699,769)	(59,175)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(2,699,769)	(59,175)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	(1,712,498)	(2,588,807)
Dividendë të paguar	(10,293,337)	(13,480,650)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(12,005,835)	(16,069,457)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	6,024,149	5,294,517
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	7,260,479	1,978,910
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(342,201)	(12,948)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 12,942,427	7,260,479

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

“Albanian Digital Printing Solutions & Services” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 18 Mars 2011 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Kapitali i nënshkruar i shoqërise është 100 Lek, i ndarë në 2 kuota.
Ortakët e shoqërise janë:

- Albdesign PSP zotërues i 24.5% të kapitalit të shoqërisë;
- Inform P.Lykos S.a Processing & Development of Printed Information System zotërues i 75.5% të kapitalit të shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është shitje e shtypshkrimeve dixhitale dhe menaxhim i të gjitha llojeve të dokumenteve dhe shtypshkrimeve. Tregti e të gjitha produkteve të ngjashme dhe makinerive që lidhen me këtë lloj aktiviteti. Shtypshkrim dhe menaxhim i dokumenteve me elemente sigurie. Përfaqësim në Shqipëri i shoqërive të huaja me aktivitet të ngjashëm.

Selia e shoqërise është në adresën: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 5, Kashar, Tiranë.
Më 31 dhjetor 2018 Shoqëria kishte 17 punonjës (2017: 17 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdher hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo

(Vlerat janë në Lek)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë.

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paaftësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2018	2017
Euro/ALL	123.42	132.95
USD/ ALL	107.82	111.10

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orendi	Vlerë e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25%
Makineri dhe pajisje	Vlerë e mbetur	20%
Automjete	Vlerë e mbetur	20%
Të tjera	Vlerë e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivitet dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Mjete monetare në bankë	12,922,001	7,173,078
Llogari rrjedhëse	12,922,001	7,173,078
Mjete monetare në arkë	20,426	87,401
	<u>12,942,427</u>	<u>7,260,479</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Klientë	17,258,048	24,164,932
	<u>17,258,048</u>	<u>24,164,932</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të arkëtueshme tregtare nga Albdesign PSP	89,893	167,952
	<u>89,893</u>	<u>167,952</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Tatim mbi fitimin	1,325,434	-
TVSH e kreditueshme	2,386,570	76,969
Detyrime doganore	146,753	142,173
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	160,000	105,000
	<u>4,018,757</u>	<u>324,142</u>

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

8. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Lendë e parë dhe materiale	10,144,009	10,443,267
Mallra për rishitje	268,118	268,119
Produkt i gatshëm	532,191	-
	<u>10,944,318</u>	<u>10,711,386</u>

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime të periudhave të ardhme	10,469,679	4,281,684
	<u>10,469,679</u>	<u>4,281,684</u>

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive afatgjata materiale

	Makineri dhe Pajisje	Automjetet	Mobilje dhe orendi	Paisje kompjuterike	Te tjera	Totali
Kosto						
Gjendja më 31 dhjetor 2016	47,030,472	953,836	73,041	3,342,608	3,210,496	54,610,453
Shtesa				7,916	51,260	59,176
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjëndja më 31 dhjetor 2017	47,030,472	953,836	73,041	3,350,524	3,261,756	54,669,629
Shtesa				2,346,873	352,896	2,699,769
Nxjerrje jashtë përdorimit					(125,000)	(125,000)
Gjëndja më 31 dhjetor 2018	47,030,472	953,836	73,041	5,697,397	3,489,652	57,244,398
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 31 dhjetor 2016	(28,530,236)	(445,119)	(30,767)	(2,100,726)	(1,499,206)	(32,606,054)
Amortizimi i vitit	(3,430,908)	(101,748)	(8,460)	(311,787)	(350,802)	(4,203,705)
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjëndja më 31 dhjetor 2017	(31,961,144)	(546,867)	(39,227)	(2,412,513)	(1,850,008)	(36,809,759)
Amortizimi i vitit	(2,778,369)	(81,394)	(6,765)	(234,503)	(306,029)	(3,407,060)
Nxjerrje jashtë përdorimit					81,978	81,978
Gjëndja më 31 dhjetor 2018	(34,739,513)	(628,261)	(45,992)	(2,647,016)	(2,074,059)	(40,134,841)
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2016	18,500,236	508,717	42,274	1,241,882	1,711,290	22,004,399
Gjendja më 31 dhjetor 2017	15,069,328	406,969	33,814	938,011	1,411,748	17,859,870
Gjendja më 31 dhjetor 2018	12,290,959	325,575	27,049	3,050,381	1,415,593	17,109,557

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

11. Aktive afatgjata jo materiale

	<u>AAJM</u>	<u>Total</u>
Me kosto		
Gjendja më 31 dhjetor 2017	86,346	86,346
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	86,346	86,346
Amortizimi		-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	51,253	51,253
Amortizimi i vitit	12,951	12,951
Gjendja më 31 dhjetor 2018	64,204	64,204
Gjendja Neto më 31 dhjetor 2017	35,093	35,093
Gjendja Neto më 31 dhjetor 2018	22,142	22,142

12. Hua aftashkurta

Në këtë zë është paraqitur overdrafti nga bankat dhe qiratë financiare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Overdraft Raiffeisen Bank	-	13,659
Raiffeisen Leasing Financial lease	-	1,552,066
Porsche Leasing Financial lease	23,435	144,964
	23,435	1,710,689

13. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Furnitorë vendas	1,756,088	2,380,321
Furnitorë të huaj	1,957,978	6,960,284
	3,714,066	9,340,605

14. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të pagueshme tregtare	18,966,423	8,138,509
	18,966,423	8,138,509

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

15. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshmet për shpenzime të konstatuara më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Furnitorë për fatura të pambërritura	11,750	10,823
	<u>11,750</u>	<u>10,823</u>

16. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	240,685	218,285
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	109,082	102,785
Tatim në burim	311,956	311,909
Tatim fitimi	-	483,204
	<u>661,723</u>	<u>1,116,183</u>

17. Të ardhura të shtyra

Të ardhurat e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Parapagime Vodafone	5,086,215	-
	<u>5,086,215</u>	<u>-</u>

18. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime ndaj personelit	2,638	-
Të tjera detyrime	16,363	16,363
	<u>19,001</u>	<u>16,363</u>

19. Hua afatgjata

Huatë afatgjata paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Qira financiare Porsche Leasing	-	25,244
	<u>-</u>	<u>25,244</u>

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

20. Kapitali themeltar

Kapitali i shoqërisë "Albanian Digital Printing Solutions & Services" sh.p.k. është 100 Lekë, i ndarë në 2 kuota.

Kapitali i shoqërisë nuk ka ndryshuar ne vlerë por ka pësuar ndryshime në pronësinë e tij.

Me vendimin e datës 31.07.2018 është miratuar shitja e 24.5 % të kuotave te kapitalit qe zoteron Wildermore Holdings tek ortaku i ri Shoqeria "INFORM P.LYKOS S.A PROCESSING & DEVELOPMENT OF PRINTED INFORMATIONS SYSTEMS "sipas kontrate blerje kuotash date 01.08.2018.

21. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga shitja e produktit të vetë	70,023,340	87,986,928
Të ardhura nga shitja e mallrave	560,882	512,896
Të ardhura nga shërbimet	2,461,596	10,926,595
	73,045,818	99,426,419

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruar në FDP TVSH	78,182,585
Ndryshimi i gjendjes së parapagimeve	(5,524,221)
Zbritje nga shitjet për arkëtim në avancë	387,454
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	73,045,818
Shitje produkte të gatshme	70,023,340
Shitje mallrash	560,882
Shërbime	2,461,596
Të ardhura të deklaruar në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	73,045,818
Fitim nga këmbimet valutore	1,088,136
Total të ardhura të deklaruar FDP e Tatim Ftimit	74,133,954

22. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fitime nga këmbimet valutore	1,088,133	805,552
Humbje nga këmbimet valutore	(871,390)	(292,910)
	216,743	512,642

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

23. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Kosto e materialeve të para	25,578,489	29,651,501
Kosto e materialeve të ambalazhimit	621,726	650,050
Pjesë këmbimi	1,578,963	3,726,484
Materiale të tjera ndihmëse	26,249	82,423
Kosto e mallrave të shitur	411,557	377,820
Nënkontraktorë	3,365,697	11,470,676
Mirëmbajtje dhe riparime makinerite dhe fabrika	341,505	970,974
Qjira	3,292,129	3,465,671
Prime sigurimi	142,780	81,233
Energji elektrike	760,523	855,806
Shërbime nga të tretë	-	69,016
IT Servis	1,215,962	1,098,192
	<u>37,335,580</u>	<u>52,499,846</u>

24. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Konsulenca ekonomike dhe juridike	2,308,237	2,257,954
Shpenzime për licence software, konfigurim , setup	1,202,570	1,225,170
Blerje të ndryshme, kancelari etj	475,860	127,334
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	296,564	637,387
Shërbime nga të tretë	270,526	258,088
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	265,439	330,327
Kosto udhëtimi dhe akomodimi tekniket	205,716	39,124
Taksa të ndryshme	199,000	199,098
Komisione bankare	165,703	297,197
Mirëmbajtje dhe riparime	146,544	313,578
Shpenzime administrative dhe noteriale	122,997	293,498
Siguracione	86,865	53,727
Dhurata	59,220	151,600
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	26,195	15,536
Shpenzime për pritje	-	14,550
	<u>5,831,436</u>	<u>6,214,168</u>

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

25. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime për paga	13,019,161	13,842,291
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	1,602,119	1,745,574
Shpenzime të tjera për punonjësit	-	12,470
	<u>14,621,280</u>	<u>15,600,335</u>

26. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Gjoka dhe penalitete	2,012	488
	<u>2,012</u>	<u>488</u>

27. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime për interesa	(94,277)	(326,634)
Zbritje nga shitjet për arkëtim në avancë	(387,454)	(299,082)
	<u>(481,731)</u>	<u>(625,716)</u>

Albanian Digital Printing Solutions & Services Shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Fitimi para tatimit	12,102,702	20,771,590
Shpenzime te panjohura te tjera (si me poshte)	459,157	1,025,576
Shpenzime pritje dhe percjellje, dhurata	59,220	151,600
Shpenzime udhetimi	3,000	-
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	2,012	488
Vlera neto e aseteve të dala jashtë përdorimi	43,022	-
Shpenzime të tjera	351,903	873,488
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	12,561,859	21,797,166
Tatim fitimi 15%	1,884,279	3,269,575
	<u>10,218,423</u>	<u>17,502,015</u>

29. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Bilanci kontabël		
<i>Të pagueshme ndaj palëve të lidhura</i>		
Inform P.Lykos SA	3,562,187	3,826,103
Albdesign PSP	15,404,236	4,312,406
	<u>18,966,423</u>	<u>8,138,509</u>
<i>Të arkëtueshme nga palët e lidhura</i>		
Albdesign PSP	89,893	167,952
	<u>89,893</u>	<u>167,952</u>

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve		
<i>Shitje palëve të lidhura</i>		
Albdesign PSP	1,868,168	2,040,648
	<u>1,868,168</u>	<u>2,040,648</u>
<i>Blerje nga palët e lidhura</i>		
Inform P.Lykos SA	11,334,761	13,208,178
S.C. INFORM LYKOS S.A.	1,200,960	1,207,151
Albdesign PSP	21,050,242	15,800,117
	<u>33,585,963</u>	<u>30,215,446</u>

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

30. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 dhjetor 2018 shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

31. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.